

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaRep®-400 Extra

LLAÇ ÇIMENTOJE ME 1 PËRBËRËS DHE I PËRFORCUAR ME FIBRA PËR RIPARIME NË STRUKTURA BETONI, KATEGORIA R4



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaRep®-400 Extra është llaç çimentoje gati për përdorim dhe i përforcuar me fibra për punime të zakonshme riparimi betoni, në trashësi të madhe, i cili plotëson kërkesat e kategorisë R4 të EN 1504-3.

PËRDORIMET

- Riparim dhe riprofilizim / rinxjerrje në sipërfaqe të betonit në zona të dëmtuara mbi sipërfaqe vertikale ose horizontale
- Mbushje e vrimave, poreve, defekteve të vogla, skajeve dhe mbushje, formim dhe përfundim të fugave dhe mbulimeve
- I përshtatshëm për punime restaurimi (Parimi 3, Metoda 3.1, EN 1504-9). Riparim i betonit të copëtuar dhe dëmtuar në ndërtesa dhe projekte superstrukturore
- Riparim dhe riprofilizim betoni (Parimi 4, Metoda 4.4, EN 1504-9). Rritje e kapacitetit bartës të strukturës prej betoni duke shtuar llaç
- I përshtatshëm për ruajtje ose restaurim të pasivitetit (Parimi 7, Metoda 7.1 & 7.2, EN 1504-9). Rritje e mbulimit me llaç ose beton shtesë ose me zëvendësim të betonit të kontaminuar apo të karbonuar

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kategoria R4 sipas EN 1504-3
- Për trashësi aplikimi midis 5 mm dhe 35 mm me aplikim manual (për shtresë)
- Punueshmëri e shkëlqyer, tiksotropi e lartë
- Përdoret dhe punohet lehtë
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e materialeve të ndërtimit (beton, gur, çelik)
- Qëndrueshmëri e mirë përmasash
- I përshtatshëm për punime riparimi të strukturave prej betoni me kategori rezistence të ulët deri mesatare për shkak të modulit të ngjashëm të ulët të elasticitetit
- Rezistenca të larta ndaj ngjeshjes, përkuljes dhe tërheqjes
- Sipërfaqe përfundimtare shumë e mirë

MIRATIME / STANDARDE

Llaç për riparime CC për riparime në strukturat prej betoni në ndërtesa dhe vepra të inxhinierisë së ndërtimit, Kategoria R4 sipas EN1504-3:2005. Parimet 3, 4 & 7, Metodat 3.1, 4.4, 7.1 & 7.2 sipas EN1504-9:2008. Deklarata e Performancës 10259644 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, agregate të përzgjedhura, tym silici dhe aditivë
Ambalazhi	Thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri me fibra
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të magazinohet saktë, në ambalazhin origjinal, të pahapur, të vulosur dhe të padëmtuar në kushte të thata, në temperatura midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga lagështia.

Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 2.15 kg/lit
Përmasa maksimale e kokrrizës	~1.8 mm
Përmbajtja në jone të tretshme kloruri	≤ 0.05 % (EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	1 ditë	7 ditë	28 ditë	Kërkesat Kategoria R4, 28 ditë	(EN 12190)
	≥ 25 MPa	≥ 40 MPa	≥ 50 MPa		
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	Rezultatet		Kërkesat Kategoria R4		(EN 13412)
	25 GPa		≥ 20 GPa		
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	1 ditë	7 ditë	28 ditë	(EN 196-1)	
	≥ 4.0 MPa	≥ 5.5 MPa	≥ 8.0 MPa		
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Rezultatet		Kërkesat Kategoria R4		(EN 1542)
	≥ 2.5 MPa		≥ 2.0 MPa		
Tkurrja / bymimi i kontrolluar	≥ 2.0 MPa			(EN 12617-4)	
Kompatibiliteti termik	≥ 2.0 MPa			(EN 13687-1)	
Reagimi ndaj zjarrit	Euroclass A1				
Absorbueshmëria kapilare	≤ 0.5 kg/m ² x v _h			(EN 13057)	
Rezistenca ndaj karbonimit	d _k ≤ beton kontrolli (MC (0.45))			(EN 13295)	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	SikaRep®-400 Extra është pjesë e serisë të llaçeve Sika® që plotëson pjesën përkatëse të Standardit European EN 1504 dhe përbëhet nga:	
	Prajmer ngjitjeje dhe mbrojtje kundër korrodimit të armaturës:	
	Sika® MonoTop®-910 N	Përdorim normal (EN 1504-7)
	SikaTop® Armatec® 110 EpoCem®	Kërkesat (EN 1504-7)
	Llaç riparimi:	
	SikaRep®-400 Extra	Kategoria R4, llaç për riparime strukturore, me mallë & dorë
	Niveluesi / izoluesi i poreve:	
	Sika® MonoTop®-621 Evolution	Kërkesa normale (EN 1504-2)
	Sikagard®-720 EpoCem®	Kërkesa të larta (EN 1504-2 & EN 1504-3)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	4.0 – 4.5 lt ujë për thes 25 kg, në varësi të punueshmërisë së dëshiruar
Konsumimi	~ 1.8 kg/ m ² për mm trashësie në varësi të ashpërsisë së nënshtresës
Trashësia e shtresës	min. 5 mm / max.35 mm
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.
Koha e punueshmërisë	~ 45 minuta (në +20°C)

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Beton:

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme, të jetë plotësisht e pastër, pa pluhur, papastërti dhe materiale të lira, ndotje sipërfaqësore si vaj ose graso, kore çimentoje, të cilat do të reduktojnë ngjitjen ose do të pengojnë thithjen apo lagjen. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes (shqitjes) duhet të jetë > 1.5 MPa.

Betoni i shpetëzuar, i dobët, i dëmtuar dhe përkeqësuar duhet të hiqet me mjete të përshtatshme.

Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme përgatitjeje, si uji me presion të lartë ose retifikimi, vegla thyerëse mekanike ose manuale. Preferohen metoda pastrimi jovibruese. Agregatet duhet të duken qartazi mbi sipërfaqen e zonës së përgatitur. Skajet e zonës që do të riparohet duhet të priten vertikalisht (kënd 90°) në një thellësi minimale prej 5 mm.

Armatura prej çeliku:

Sipërfaqja e çelikut duhet të jetë pa ndryshk, llaç, mbetje betoni, vaj, graso, pluhur dhe grimca të tjera të lira të cilat mund të reduktojnë lidhjen ose mund të kontribuojnë tek korrodimi.

Në rast ndryshku, pastroni në mënyrë të njëtrajtshme të gjithë perimetrin e shufrave prej çeliku (ku është e aplikueshme) duke përdorur teknika pastrimi me rrymë abrazive ose pastrim me presion të lartë rryme uji të paktën deri në Sa 2 ½ në përputhje me ISO 8501-1.

Nëse kërkohet, aplikoni përreth të gjithë perimetrin të ekspozuar dy shtresa inhibitor korrodimi si Sika® MonoTop®-910 N ose SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® (ju lutemi lexoni skedën teknike të produktit përkatës). Mbroni shufrat e pastruara nga kontaminimi i mëtejshëm, përpara se të aplikoni llaçin.

Referohuni gjithashtu edhe në EN1504-10 për kërkesa specifike.

PËRZIERJA

SikaRep®-400 Extra mund të përzihet me një përzierës elektrik dore në shpejtësi të ulët (~ 500 r.p.m.) ose duke përdorur një përzierëse të fuqishme me govatë për sasi të mëdha. Hidhni ujin në sasinë e saktë të dëshiruar brenda një konteneri të përshtatshëm për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht për të paktën 3 minuta, duke shtuar ujë shtesë gjatë kohës së përzierjes deri në maksimumin e sasisë së specifikuar, deri sa të arrihet një konsistencë homogjene dhe pa kokrriza. Përzieni të gjithë thesin për rezultate më të mira.

25 kg e pluhurit SikaRep®-400 Extra përzihet me 4.0 - 4.5 lt uji në varësi të konsistencës së dëshiruar

APLIKIMI

Aplikimi i SikaRep®-400 Extra mund të bëhet me mallë ose me dorë (për riparime betoni, dekorime, ballkone, skajet e shtyllave etj.) mbi sipërfaqen e përgatitur saktë. Lagni paraprakisht mirë nënshtresën e përgatitur, rekomandohet 2 orë përpara aplikimit të SikaRep®-400 Extra.

Mbani sipërfaqen të lagur dhe mos lejoni që të thahet. Përpara aplikimit largoni ujin e tepërt p.sh. me sfungjer të pastër. Sipërfaqja duhet të ketë paraqitje ngjyrë të errët mat pa shkëlqim dhe porët dhe gropëzat sipërfaqësore nuk duhet të përmbajnë ujë. Aplikoni shtresën fillestare duke hedhur llaçin riparues mbi nënshtresë për të formuar një shtresë të hollë dhe duke mbushur porët ose gropëzat mbi sipërfaqe. Sigurohuni se e gjithë sipërfaqja që do të riparohet është mbuluar me shtresën fillestare. Pastaj, aplikoni produktin duke ushtruar forcë të madhe dhe duke ngjeshur produktin mirë tek zona.

Kur kërkohet prajmer (sidomos kur shufrat e armimit duhet të trajtohen kundër korrodimit), sigurohuni se është ende i ngjithshëm kur materiali për riparim ngjeshet përsipër (teknika: i lagësht mbi të lagësht). Referohuni tek Informacionet mbi Sistemin për produkte Sika kompatibël dhe tek skedat teknike përkatëse për më shumë informacione të hollësishme (p.sh Sika MonoTop® -910 ose SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®).

Trashësia e shtresave të aplikimit duhet të jetë midis 0.5 dhe 3.5 cm. Trashësitë më të mëdha duhet të ndërtohen në shtresat vijuese kur llaçi ka filluar të mpikset (nuk ngjit). Mos e lëmoni shtresën e parë përpara aplikimit të shtresës së dytë.

Sipërfaqja mund të finirohet sipas kërkesave duke përdorur një mallë të sheshtë ose suvatimi (mallë me sfungjer) ndërsa është e lagur ose me një vegël të përshtatshme suvatimi për muret e jashtme, sapo llaçi të ketë filluar të ngurtësohet. Mos e punoni sipërfaqen e finiruar. Në diell apo erë të fortë, llaçi duhet të mbrohet me mjete të përshtatshme që të mos thahet shumë shpejtë.

METODA E MATURIMIT

Mbroni llaçin e freskët të aplikuar nga dehidratimi dhe/ose tharja e parakohshme duke përdorur metodat e përshtatshme të trajtimit (të paktën për 24 orë), p.sh. përbërës trajtimi si Sika® Antisol® ose Sikafloor® Proseal sapo të jetë avulluar uji mbi sipërfaqe.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Largimi i mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të largohet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Referohuni tek Sika Method of Statement për "Riparinin e betonit duke përdorur Ilaçet gati për përdorim Sika®" (Ref.8503201) për më shumë të dhëna rreth aplikimit të sistemit të riparimit, përgatitjes së sipërfaqes dhe/ ose rekomandimeve që jepen prej EN 1504-10
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Mos shtoni çimento apo substanca të tjera që mund të ndikojnë tek vetitë e Ilaçit
- Mos shtoni ujë ose Ilaç të freskët tek përzjerja e Ilaçit e cila ka filluar tashmë të mpikset
- Shmangni aplikimin në diell dhe/ ose erë të fortë
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura
- Mbroni materialin e sapoaplikuar nga ngrirja dhe nga shiu
- Mos shtoni sasi shtesë uji gjatë finiturës së sipërfaqes, pasi kjo gjë do të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje
- Për aplikime tavanore, mos e tejkaloni trashësinë prej 25 mm për shtresë në aplikimet me dorë
- Regjistroni temperaturat e mjedisit dhe ambientit përpara dhe gjatë aplikimit

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaRep®-400 Extra

Mars 2019, Botimi 01.01

020302040030000138

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaRep-400Extra-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf